UDHËZIM
Nr. 169, datë 13.10.2025

PËR NDALIMIN E QARKULLIMIT TË PATINAVE ELEKTRIKE OSE KOMBINIMIT TË TYRE, NË RRUGË URBANE DHE TROTUARE

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102, të Kushtetutës, të neneve 5, 6 dhe 7, të ligjit nr. 8378, datë 27.7.1998, "Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, të pikës 9, të nenit 3, të ligjit nr. 82/2024, "Për Policinë e Shtetit", ministri i Punëve të Brendshme,

UDHËZON:

1. Ndalimin e qarkullimit të patinave elektrike ose kombinimit të tyre, për arsye të sigurisë publike dhe sigurisë së qarkullimit rrugor në rrugë urbane dhe trotuare që ndikojnë në rrjedhshmërinë e qarkullimit dhe në segmentet rrugore për përdorim publik.
2. Zbatimi i ndalimit të qarkullimit të këtyre mjeteve të përcaktuara në pikën 1 të këtij udhëzimi, do të bëhet për një periudhë të pacaktuar, deri në rishikimin e kuadrit ligjor.
3. Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit në zbatim të misionit të saj për ruajtjen e rendit dhe sigurisë publike, të marri masat e nevojshme për ndalimin e qarkullimit të patinave elektrike ose kombinimit të tyre, deri në rregullimin e kuadrit ligjor mbi përdorimin e tyre.
4. Organet e vetëqeverisjes vendore të marrin masa për zbatimin e këtij udhëzimi me urdhëresa dhe vendosje të sinjalizimeve rrugore.

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I PUNËVE TË BRENDSHME
Albana Koçiu